




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 03.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **08.02.2019**, të parashtruar nga OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër** ”, me nr të prokurimit **651-20-3398-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 035 521** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër** ”, me nr të prokurimit **651-20-3398-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 035 521** e dt. **31.10.2020** kundër Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **31.08.2020** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjilanit** vendos të vazhdojë sipas Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **31.08.2020**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a me datë **31.10.2020**, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër** ”, me nr të prokurimit **651-20-3398-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 035 521**. Autoriteti Kontraktues me datë **03.11.2020** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë të datës 31.08.2020 më saktësisht tek Vlefshmëria e Tenderit është kërkuar nga OE që ti përmbahen Kushtit Kryesor Administrativ prej 90 ditë :

Autoriteti Kontraktues-Komuna e Gjilanit ne harmoni me vendimin e datës 09.10.2020 te OSHP-së ka formuar komisionin për ri vlerësimin e ofertave.

-Komisioni i ri-vlerësimit te ofertave, ofertën tuaj e ka vlerësuar si ofertë te pa përgjegjshme pasi qe ju se bashku me ofertën keni dorëzuar Formularin e tenderit me validitet prej 60 ditësh e jo ashtu siç ishte kerkuar nga Autoriteti Kontraktues ne DT dhe ne NJPK, qe validiteti I ofertave te jete 90 dite. Komisioni I ri vlerësimit te ofertave ka vepruar ne harmoni me nenin 72 te LPP-s dhe 39 te RRUOPP kur Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon thotë: Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm sepse është kusht administrativ.

-Ne fazën e ri-vlerësimit te ofertave Autoriteti Kontraktues për te qene ne harmoni me kërkesat e nenit 31.4 te RRUOPP ka kerkuar vazhdimin e validitetit te ofertave vetëm nga ata OE te cilët Formularin e tenderit e ka dorëzuar dhe plotësuar sipas kërkesave te AK-s te vendosura ne DT dhe ne NJPK.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Izet Kurteshi



U.D Menaxher i zyrës së Prokurimit

**Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.**